

TAKIMI I DYTË 2025 - KOMITETI SEKTORIAL I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT DHE KOMITETI SEKTORIAL I MIKPRITJES DHE TURIZMIT

Takimi i dytë 2025 u mbajt më datë **30.05.2025**.

Takimi i dytë ishte një takim i përbashkët i Komitetit Sektorial të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit dhe Komitetit Sektorial të Mikpritjes dhe Turizmit. Zhvillimi i këtij takimi të përbashkët u konsiderua si një hap i parë i rëndësishëm për vendosjen e marrëdhënieve të konsoliduara të bashkëpunimit ndërmjet dy sektorëve. Takimi u vlerësua si një mundësi shumë e mirë për të dy sektorët, pasi megjithëse kishin objektiva të ndryshëm ato nuk mund të zhvilloheshin pa njëri - tjetrin. U evidentua se, sektori i turizmit nuk mund të zhvillohej pa digjitalizimin, ndërsa sektori i TIK-ut duhej të shfrytëzonte nevojat e turizmit për zhvillimin e produkteve të reja.

Në vijim të takimit, u bë prezantimi i gjetjeve kryesore të studimit të UNDP Albania me temë *“Ndikimi i digjitalizimit në sektorët prioritarë të ekonomisë: energji, TIK dhe turizëm”*. Studimi ishte përqendruar në tre sektorë prioritarë: energjinë, TIK-un dhe turizmin, me qëllim identifikimin e nivelit të digjitalizimit të kompanive që operonin në këto fusha në Shqipëri. Nga studimi rezultonte se, në Shqipëri numri më i madh i kompanive ndodhej në nivelin e dytë të digjitalizimit. Edhe pse kishte kompani në nivelin e parë apo të tretë, shifrat nuk ishin domethënëse. Si problematikë u identifikua ekspozimi i kufizuar ndaj teknologjive më të avancuara dhe ndaj profesioneve të tjera digjitale përveç programuesit. Studimi evidentonte gjithashtu se, sektori i turizmit kishte nevojë të lartë për produkte digjitale, por kishte prirje t’i blinte ato nga kompani të huaja. Kjo u konsiderua se, mund të vinte si pasojë e mungesës së informacionit ose e mungesës së përputhshmërisë ndërmjet nevojave të turizmit dhe produkteve të zhvilluara nga kompanitë vendase të TIK-ut.

Në këtë proces u theksua edhe rëndësia e shkollave të mesme profesionale, pasi ato konsideroheshin si institucione kyçe për formimin e infrastrukturës së nevojshme njerëzore për mbulimin e aktiviteteve dhe proceseve përkatëse. U nënvizua se, përdorimi i platformave inovative dhe teknologjive të avancuara mund të ndihmonte bizneset në reduktimin e kostove dhe të nevojës për burime njerëzore, një problem ky i konsideruar kritik për bizneset. Në kuadër të diskutimit mbi rritjen e bashkëpunimit ndërmjet dy sektorëve, u propozua që të mendohej dhe punohej për identifikimin e një kualifikimi të ri profesional, i cili mund të ishte brenda sektorit të TIK-ut, por jo domosdoshmërisht, me qëllim përgatitjen e një figure profesionale “Innovation specialist”. U theksua se, kjo figurë nuk do të kishte domosdoshmërisht rol implementues, por do të kishte njohuri mbi mundësitë e përdorimit të teknologjisë, skemat e financimit dhe do të ishte në gjendje të identifikonte produkte apo zgjidhje inovative që mund të financoheshin nga fondet e Bashkimit Evropian apo burime të tjera. Gjithashtu, u vlerësua si e rëndësishme zhvillimi i një forumi të përbashkët ndërmjet dy sektorëve dhe krijimi i një katalogu për produktet TIK, pasi do ta bënte ofertën më transparente dhe tregun më të lexueshëm nga pikëpamja e produkteve shqiptare që

mund të ofroheshin. U sugjerua që në panairin e ardhshëm të turizmit të krijohej hapësirë për përfshirjen e aktorëve të sektorit të TIK-ut, duke i dhënë këtij bashkëpunimi prioritet më të lartë.

Pjesa e fundit e mbledhjes u përqëndrua në validimin e dokumenteve. Anëtarët u ndanë në dy grupe sipas fushës së përgjegjësisë. Secili Komiteti validoi standardet përkatëse. Sekretariati Teknik prezantoi draft-in final të standardit të profesionit: ***“Menaxher i mesëm në hotel dhe restorant”***. Pas prezantimit të funksioneve dhe detyrave për secilin funksion, standardi u validua pa ndryshime. Po e njëjta metodë u ndoq dhe për standardin e profesionit: ***“Ndihmës në TIK”***. Pas diskutimit të funksioneve dhe detyrave, standardi u validua me disa ndryshime të vogla në formulim, por pa ndryshime përmbajtësore. Pas validimit të standardeve të profesioneve, u kalua në diskutimin e standardeve të kualifikimeve profesionale. Sekretariati prezantoi njësitë e të nxënit që përmbanin standardet e kualifikimit dhe peshën specifike për secilën njësi. Standardi i kualifikimit profesional ***“Hoteleri - Turizëm”***, niveli IV në KSHK, u validua pa ndryshime. Standardi i kualifikimit profesional ***“Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”***, niveli II në KSHK, u validua me disa ndryshime të vogla në formulim, por pa ndryshime përmbajtësore.

Vendime të marra nga mbledhja:

- Për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet dy sektorëve, u propozua që kompanitë e IT-së t'i bashkoheshin panairit të përvitshëm të turizmit për të prezantuar produktet e tyre në funksion të këtij sektori.
- U propozua krijimi i një katalogu me produktet e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit që prodhoheshin në Shqipëri, i cili do t'u shërbente të gjithë sektorëve, përfshirë turizmin.
- U propozua zhvillimi i një forumi të përbashkët me përfshirjen e tre aktorëve kryesorë: bizneseve, universiteteve dhe institucioneve qeverisëse, si hapësirë për përcjelljen e nevojave të dy sektorëve.
- U propozua identifikimi i një kualifikimi të ri profesional për përgatitjen e një ***“Innovation specialist”***.
- U validuan pa ndryshime standardet e profesioneve: ***“Ndihmës në TIK”*** dhe ***“Menaxher i mesëm në hotel dhe restorant”***.
- U validuan pa ndryshime standardet e kualifikimeve profesionale: ***“Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”***, niveli II në KSHK dhe ***“Hoteleri - Turizëm”***, niveli IV në KSHK.